

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

25 Shkurt, 2022

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka arritur një moment historik në përpjekjet e saj të vazhdueshme për t'ju ofruar të gjithë nxënësve mjediset e të mësuarit të shekullit të 21-të që u nevojiten për të pasur sukses. Në mbledhjen e tij mbrëmë, Bordi i Arsimit miratoi kontratat për dy organizata që do të bashkëpunojnë me zyrtarët e Drejtorisë për Proçesin e ri të Planifikimit të Objekteve (FPP) që do të nisë më 22 Mars 2022.

FPP është një komponent kritik i planit strategjik të Drejtorisë për të ofruar zgjidhje të mundshme në lidhje me vështiresite e objekteve dhe shfrytëzimit të shkollave. Nëpërmjet ndarjes së të dhënave, angazhimit dhe shtrirjes së komunitetit në – person dhe online, Drejtoria do të kërkojë mendime nga komuniteti i shkollës për opsionet e barabarta për të ardhmen e mjediseve të tij mësimore. Këto opsione do të çojnë në rekomandimet përfundimtare që do t'i paraqiten Bordit në pranverën e vitit 2023 dhe përfundimisht do të informojnë Masterplanin e Objekteve të Drejtorisë, një rrugë strategjike afatgjatë përpara për të priorizuar shpenzimet e investimeve të objekteve dhe për të siguruar që të gjitha hapësirat mësimore të jenë të pajisura me mjetet. dhe burimet që u nevojiten studentëve për të arritur sukses.

Gjatë trembëdhjetë muajve të ardhshëm, të gjitha komunitetet shkollore do të vlerësohen si pjesë e proçesit. Bazuar në këto vlerësime, shkollat mund të përfshihen më pas në biseda të drejtuara nga organizatorët, të krijuara për të informuar rekomandimet përfundimtare. WXY Studios do të udhëheqë përpjekjen e gjerë të angazhimit të komunitetit ndërsa Skai Blue Media do të ofrojë mbështetje strategjike të komunikimit për të mbajtur komunitetet e shkollave të informuara gjatë gjithë proçesit.

FPP zgjeron punën që tashmë është duke u zhvilluar për të përmirësuar kushtet e objekteve në të gjithë Drejtorinë dhe për të ofruar mjedise të drejta mësimore për **të gjithë** studentët. Ai gjithashtu bazohet dhe zëvendëson proçesin e angazhimit të komunitetit që filloi nën Rishikimin Gjithëpërfshirës të Planifikimit të Shkollës (CSPR), një iniciativë që u ndërpre në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID-19.

Në Mars, do të publikohet një plan i plotë projekti, duke përfshirë një afat kohor të plotë të projektit me datat kur do të publikohen të dhënat si dhe detaje mbi proçesin e angazhimit të komunitetit. Për më shumë informacione mbi Proçesin e Planifikimit të Faciliteteve (FPP) dhe për të qëndruar të përditësuar mbi projektin, vizitoni philasd.org/facilitiesplanning.

Sinqerisht,

A handwritten signature in cursive script, reading "William R. Hite Jr." with a stylized flourish at the end.

William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias